

## Procesverbal

Nga mbledhja e VI - (gjashtë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 26.06.2023

### Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e VI-të,
- 3) Eventuale.

**Uran Halimi:** Mirëmëngjes! Përshëndetje për të gjithë! E kemi mbledhjen e VI-të të rregullt për vitin 2023 të KPF-së, ku siç e dini është paraparë ky rend i ditës: tek pika e parë e kemi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar; shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e VI-të, edhe e kemi pikën e tretë të fundit, pikën eventuale. A do me e marrë fjalën dikush në lidhje me këtë rend të ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës për këtë Komitet? Kundër a ka? Abstenim? Gjashtë vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, kalon rendi i ditës. E kemi pikën e parë, miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse dikush me e marrë fjalën në lidhje me procesverbalin? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Me 7 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, kalon edhe pika e parë. Po kalojmë te rendi i ditës së seancës së rregullt. E kemi vetëm një pikë, përveç asaj eventuales, siç e dini, është miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026. A do dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë?

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Unë shumë i shkurtë do të jem, veç te lista e shpenzimeve kapitale për vitin 2024-2026. E nderuara qeveri e Komunës së Dragashit, kur kemi qenë na në pushtet na keni akuzue se kemi qit shumë tendera me shuma shumë të ulta, veç sa m'i kalue. Hiç nuk jeni ma mirë edhe ju sivjet. Shumë mirë keni bo që ndërtimin e Ujësujellit kryesor do ta ndreqni, edhe ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e ujit në Dragash, po kishte qenë mirë qeto ka 7 mijë, ka 5 mijë, ka 10 mijë, hiç bre mos m'i qit sivjet nëpër fshatra. Për shembull, edhe në fshatin Rrenc me 10 mijë euro çka mundim me bo, kubëzim, kur dikush hi me 7-8 mijë euro, edhe aty s'ka tendera që mundin me kalue, kështu ishte konë mirë deri në seancën, të enjten, me bo ndonjë ndryshim, në qoftë se ka mundësi. Ndërtimi, për shembull, dhe infrastruktura në fshatin Zgatar, me 7 mijë euro çka bojsh, hajt? As 10 metër mur s'un i bojsh. Domethënë, është mirë me investue në ndonjë fshat pak ma tepër, e ndonjë fshat me lonë krejt, për me lonë për vitin tjetër. Edhe ni pyetje për nënkryetarin, a drejtorin, s'po di. Këtu te kulturë, rini dhe sport: ndërtimi i stadionit dhe infrastrukturës përcjellëse në Dragash, 79,500 euro. Deri kur e keni marrë pushtetin na keni akuzue për vjedhje, për korrupsion, tash kam shkue i kam bo do foto atje, e kishit prish stadionin, pse nuk i çuet ni herë në përgjegjësi ata, po i mluot ato keqpërdorimet që ju i keni thonë kurse ka pas. Edhe e dyta është asfaltimi i rrugës Dragash-Stadium. Unë sa e di, sa kam marrë vesh që, këtë rrugë që e keni hap, e keni hap në mënyrë ilegale dhe për këtë duhet me dhonë përgjegjësi, se ajo rrugë është nën menaxhimin...aty e dini shumë mirë që Komuna e Dragashit dhe Sharrprodhimi kanë hala problem nëpër gjyqe, edhe është ni vendim në Komunë këtu, duhet me lexue ju - s'kam pas vakot, se probleme shëndetësore – me gjet atë dokument që në çdo vend ku ka problem Komuna me Sharrprodhimin, duhet aty mos me marrë me investue. Është vendim i gjykatës në Prishtinë. Domethënë kam me kërkue nga ju, unë sa e di, nashta jam gabim, nesër-masnesër, kemi kohë me lyp atë, edhe në seancë do të jau bije këtu që ju keni bo ni shkëlje, nashta edhe drejtori munden me na dhonë informata, keni bo ni shkëlje, keni bo mirë që e keni bo rrugën, po aty nuk keni guxue me hi me intervenue, për arsye se është në proces gjyqësor hala.

**Uran Halimi:** Faleminderit,! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka z.Edin Kurt.

**Edin Kurt:** Pershendetje te gjithëve. Sa i përket planit buxhetor 2024-2026, ne si JPG mbajtëm disa takime me të njëjtin rast dhe arritëm në përfundimin se ky propozim buxhet është në thelb i mirë. Ne e mbështesim këtë buxhet, është mirë për njerëzit. Fshatrat e përfshirë në këtë plan kanë probleme me ujin. Shumica e njerëzve janë të kënaqur që ky problem do të zgjidhet. Unë kam një pyetje, popullit nuk e ka të qartë se si do të lidhen, a do të lidhen me rrjetin ekzistues apo do të hapen rrjete të reja në disa fshatra. A do të paguhet uji pas kësaj dhe të ngjashme? Pres përgjigje për pyetjet e ngritura për të përcjellë te njerëzit dhe për të sqaruar çështjen e ujit.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Kurt! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Atëherë e ftoj përfaqësuesin e ekzekutivit që të japë përgjigje në lidhje me këto pyetje.

**Qamil Kolloni:** përshëndetje juve të gjithëve delegatëve, Nënkyetar Fesal edhe juve gjithashtu përshëndetje! Të nderuar delegatë, për pyetjet që i parashtrroi delegati paraprak nga PDK-ja, për këto fshatra që janë me shuma të

vogla, është ni realitet, ju e dini që ka ndikue Ujësjetllësi për 15 fshatra, gjithashtu edhe Fabrika e ujit që kemi nda 500 mijë euro, ka ndikue shumë, edhe janë diska projekte të cilat kanë ndikue që janë projekte dyvjeçare edhe realisht janë projekte të përbashkëta, që na ka ndodhë me investue në stadiume, që jemi të gjithë të kënaqur për këto investime. Mirëpo, na kemi krijuë dhe ni strategji për ndarjen e buxhetit. Në ato fshatra ku kemi qit shuma ma të vogla, ju do ta shihni se do të kenë përparësi në rastin kur do ta fitojmë Grantin e performancës, edhe falë Zotit, në bazë të gjitha raporteve të cilat na kanë ardhë, t'u fillua prej Auditorit të jashtëm, t'u fillue prej ngritjes në transparencë edhe prej Raportit për Integritim Evropian, të gjitha këta faktorë determinojnë se na do të jemi përfitues të Grantit të performancës, dhe kemi planifikue që këtyre fshatrave që iu kemi nda nga pak pare, të janë të përfshira dhe deri në shtator t'i diskutojmë edhe ni herë projektet, dhe besoj se këto fshatra do të kenë prioritet me rastin e shpërndarjes së Grantit të performancës. Rruga e Stadiumit është kontestuese. Kjo është një çështje tjetër, në qoftë se ka nevojë janë gjykatat, rruga është aty. Po ne kemi marrë pëlqim nga Ministria e Pylltarisë dhe Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, kur është hap kjo rrugë, dhe e k abo KFOR-i me pëlqim paraprak. Besoj se edhe në Kuvend e keni pas ju, delegatë, në qoftë se nuk harroni, e keni pas, e keni çue kërkesën për pëlqim në Ministri, e keni miratue nga Ministria e Pylltarisë apo Agjencioni i Pyjeve që të merret pëlqimi dhe atë pëlqim e kemi marrë dhe është krye ajo rrugë. Pse nuk i kenu çue në përgjegjësi për Stadionin? Politika nuk i çon në përgjegjësi, na e kemi krye punën tonë, i kemi ngrit ato çështje, Stadionin ka qenë ni fakt të cilin kanë mund të shohin krejt. Organet e hetuesisë merren me to edhe të prokurorisë, na nuk jemi as hetues, as prokurorë, na jemi ni qeveri lokale që mendojmë të punojmë ndershtëm dhe nuk kemi ardhë që t'i ndjekim shtrigat, po kemi ardhë që ta zhvillojmë këtë Komunë. Për atë arsye jemi t'u punue që ta ndërtojmë këtë Komunë dhe të mos merremi me fjalë të kota. Sa i përket pyetjes së delegatit tjetër, janë këto 15 fshatra të cilat janë të shkruara aty, që do të jenë përfituese të Projektit të ujit.

**Uran Halimi:** Shumë faleminderit, z.drejtor! Unë deshta me u ndërlidhë me ni pyetje që vazhdimisht qytetarët ma bëjnë. Është fjala për ndërtimin e stadiumit në fshatin Blaç. Keni kërkuë bashkëpunim edhe jau kemi dhonë 27 vota. E keni pas shumë me urgjencë, po kam qef me shkue me bo ni foto, qysh e keni marak ju, edhe te projekti i fshatit Blaç, se ju pashë që keni shkue në Kuk edhe në Bresanë, nja dy punë të vogla që janë bo. Po shumë me urgjencë u konë stadiumi i fshatit Blaç. Ato urgjencat e juaja kur p'i boni, me shumë urgjencë, deni herë p'e marrë si me shumë neglizhim që keni m'i bo. Këto me ma pak urgjencë p'i kryni, me ka 7 mijë euro, bile është mirë, Artan, këto projektet ka 7 mijë euro që i kanë, se qeto i kryjnë edhe i bojnë ka 7 mijë foto. Te stadiumi i Blaçit o burrë, se 200 mijë pyetje janë t'u m'i bo qytetarët, çka t'iu thom unë? Hajde koha e keqe ke edhe ra shumë shi, ama kohën e fundit u çelë koha, qitne ni kamion ose ni bager qaty, t'iu thom qytetarëve janë t'u punue diçka. A e dish sa me urgjencë e kemi pas, 27 vota në Kuvend i ke pas. Edhe atëherë kur VV-ja ka kundërshtue edhe ka akuzue, unë ta kam dhonë votën, bashkë me tre delegatë të VV-së, për urgjencën, për klubin KF 'Opoja' të komuës tonë. Dilni bone ni foto atje te lloçi edhe te ato gërmadhat, qysh e keni prish terrenin. Shumë ma mirë u konë qashtu qysh u konë, se kanë bo ushtrime vjet në këtë kohë KF 'Opoja' qashtu, pa urgjencë. Qetash me shumë urgjencë, s'ka ku me bo ushtrime dhe trajnim. Çka t'iu thom atyre qytetarëve unë? Koha u çelë po më thojnë, se ma herët kur ju pyeta, po bjer shumë shi. E luta Zotin, u nalë shivi. Keni kohë, e di që keni kohë, ama urgjencë u konë. Urgjencë projekt dyvjeçar. Çfarë urgjencë? Po jo, s'është problem, kur të t'vjen fjala e marrish, unë jam t'u folë hala. Artani deshti replikë, apo? Mos i ndiqni shtrigat, kqyr qato projektet kah i keni nis ndiqni. Masnej, ni projekt tjetër atje te Zaplluxhja, e dini, ni udhë të varrezave që e keni bo pa kurrëfarë plani edhe pa kurrëfarë projekti, kam hi ni ditë me motorr, u konë t'u m'zonë motorri, ni metër e diçka ish e gjonë. Çka ka me ec qaty, ti drejtor, ose nënkryetar, cilido që doni me e marrë fjalën me ma dhonë ni përgjigje? E kemi ni projekt tjetër, të stagnum, të lënë në gjys, edhe kam informacione që kanë dalë edhe e kanë hulumtue aty Inspektoriati i rrugës, te ura e Zaplluxhes, atje goxha i keni dhonë gojës në fushatë, që keni me e ndërtue urën e Zaplluxhes pa armaturë hiç. Çka janë këto projekte, kush i mbikëqyr ato dhe kush i pranon këto projekte? Mandej e kemi ni projekt, aty ku po kaloj unë çdo ditë, edhe gjysma, gati 1/3 e Opojës, te rruga e fshatit Brrut. Aty te poshtë, s'e di, nashta ju me kerra të Komunës ecni shumë shpejt, veç garant me të juajit nuk ecni hiç, se është udha shumë e keqe, e fatkeqësisht qytetarët çdo ditë, disa herë në ditë e ecin atë rrugën. Ankohnu për kohë të keqe, për shi edhe për gjithçka, projektet i vononi edhe i niseni në shtator, edhe në nëntor apat prishet koha, edhe projektet me shumë urgjencë jesin për 5 vjet bon vaki. Niset ni stadion pa u përfundue kurgjo me ni stadion tjetër. Deni punë të hairit ju kishom lut me e bo. Faleminderit shumë! Artan, mundish me e marrë fjalën.

**Artan Loshaj:** Faleminderit! Masi jemi te stadioni, po ia nisim. Jo njonin, po të dy i kanë prish. Domethënë, le që 'Opoja' s'ka ku me ushtrinë, po s'kanë ku me ushtrinë edhe klubi i Dragashit këtu, jemi t'u pague privat këtu për fëmijët e tanë. Domethënë, dy stadionet menjëherë i kanë prish. Zotni drejtor, për këto pëlqimet që thaje, po merrni edhe po japim na pëlqime, po, po qato pëlqimet që po i japim na po ju kthehen. Shumë shpejt e pate, në seancën e fundit, që ta dhashë edhe unë votën si opozitë për me marrë pompën, se thaje është e Kuvendit Komunal. Sot po punohet aty, pompën e ka marrë tjetërkush. E dyta, që thatë pushteti nuk i çon, ju i çoni, se ju jeni ata sot që menaxhoni, edhe ju jeni ata që i keni dokumentacionet, edhe ju jeni ata që i gjeni keqpërdorimet. Edhe ju duhet m'i çue atje. Tjetra, fjalët e kota edhe shtrigat, ato i njekni ju, jo ti, ju, sidomos ti si kryetar i partisë që je konë nëpër televizione, këto janë fjalët tua që i ke thonë, nuk janë fjalët e mia. Fjalë të kota nuk janë të miat, fjalë të kota janë të juajat, se nëpër televizor je. Të enjten kam me e marrë ni projektor edhe kam me ta lëshue që e ke përmend stadionin, që e ke përmend ato, e që i ke përmend krejt, domethënë qaty je. Unë ju kam thonë në fillim, tre-katër vetë keni m'u ndryshue, se të njëjtit punëtorë janë, të njëjtin drejtor e kie të Urbanizmit, të njëjtin drejtor e kie të Shëndetësisë, e mos të himë aty, krejt të njëjtit punëtorë i kie. Ju veç keni ardhë këtu ju keni thonë ej, qysh me ata e keni çue, qeshtu, a po ia grahim qeshtu, mirë është. Hajde se konga lezet, se moti s'jeni konë në pushtet. Domethënë, mu mos më akuzoni si delegat që unë po foli fjalë shtrigash edhe fjalë të kota. Fjalët e shtrigave edhe të kota janë të juajat. Për stadionin gojën plotë e keni pas. Për stadionin e keni pas gojën plotë. Unë jam konë që në pushtet, unë jam ai, qe i keni inçizimet, i keni kolegët këtu, qe Arijetën e kemi këtu, ka qenë kandidat e kalume, unë e kam akuzue pushtetin. Unë kam thonë këta duhet me shkue në përgjegjësi, pa marrë parasysh, mu nuk më intereson individi. E këto fjalët e juaja, i kam thonë edhe kryetarit, p'e dini shumë mirë, kur u pat livdue në atë, herën e parë që e pru, tha kemi pas bashkëpunime të mira, kemi punue mirë e kemi investue shumë...o kryetar, mos u gut bre, ja gjashtë muj ditë, deri t'bjer ni shi, ose deri t'bjen ni borë, e shohim. Edhe këtu jashtë, qet tenderin që e keni bo, qeto 120 copa lula që i keni mjellë, unë e kam pa projektin që ato duhet me qenë me komë, duhet me qenë ma të bukura, ju i keni vu në ciglla. Ato cigllat, ni ditë s'dita unë, e preka me kerr, ranë ato cigllat. Domethënë, i keni shue rrafsh. Edhe për këtë tenderin duhet kapak me hetue, me kqyrë, po kemi kohë. Kemi kohë, se unë projektin e kam pa, ato duhet me qenë, shumë mirë e dini, 10 cm minimum duhet me qenë e ngritme, jo m'i lshue në tokë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Munir Jonuzi e ka kërkue fjalën.

**Munir Jonuzi:** Përhëndetje të gjithëve, për sa i përket këtij buxheti në thelb është i mirë, për lexim të parë merr notë kaluese, por në fazat e mëvonshme duhet të ndryshohet dhe të përpunohet. Më vjen mirë që po zgjidhet problemi i ujit të pijshëm dhe pak më parë kolegu Edin shtroi një pyetje për të cilën ende nuk kam dëgjuar përgjigje. Më intereson edhe sesi komuna planifikon ta realizojë atë ujësjellës. Ne kemi gjashtë fshatra nga komuniteti jo-shumicë të përfshirë dhe nuk i dimë përgjigjet se si do të menaxhohet e gjithë kjo. Nuk e dimë se si do të përdoret uji, nëse do të paguhet, nëse do të lidhet me rrjetin ekzistues apo do të ndërtohet një infrastrukturë e re. Ky projekt ka filluar të zbatohet, por disa fshatra nuk duan të hyjnë në atë sistem në kushte të caktuara. Të njëjtin problem e kishim edhe në fshatin Rapçë para disa vitesh. Njerëzit nuk donin që ne t'ia jepnim dikujt tjetër për përdorim ujin që sjellim ne vetë dhe sistemin e ujit që ndërtoam vetë dhe që të paguajm ujin. Lista e investimeve kapitale është subjekt ndryshimi dhe shpresoj që në një nga fazat e ardhshme ta ndryshojmë këtë listë dhe jo vetëm të mbeshtesim një njeri që do të tregojë fuqinë e tij.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Jonuzi! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë ftoj ekzekutivin nëse ka qef m'u përgjigj, nëse jo, mundni edhe mos m'u përgjigj. Këto janë çështje që kanë me u diskutue edhe në seancë të rregullt. Okej.

**Qamil Kolloni:** Kryesues, unë të falënderoj për durimin! Mirë që erdh delegate. Tjetër herë, delegate, kqyr bre mbaj fjalët pak në mend, se nuk thashë fjalë shtrigash, po thashë ndjekje shtrigash, edhe ka dallim. Po kur s'dish, mos del me përzie, o shoq! A je me përzie, atëherë kur përzijs, stadioni të është bo në kohën e PDK-së. Ke qenë delegat, ke qenë qytetar i lirë, kie të drejtën e ankesës, shko bre ndiqi. Se të ka mbet marak m'i gjet hajnat, shkor bre ndiqi, kie qat të drejtë. PDK-ja e ka bo, e jotja. Po. Hajna more, hajna, qe, s'po ecën ma tutje, se edhe nalt e keni zonë, kahmos, hala s'e keni lëshue, Albini s'un po ju ndërron, krejt hajni jeni. Prit! Po s'po i çon zyrtari, i çon gjyqi. Na s'kemi shpirt, shko nga ti, çoj në burg. Po s'po dimë cilin hajn përpara bre, krejt, edhe burgjet s'e di a ju nxon. Kryesues, sa i përket stadionit të Blaçit, ti e dish që janë tre investitorë. Ai stadion është ndërtue me iniciativë të KF 'Opoja', në bashkëpunim me përfaqësuesit e fshatit Blaç. Gjithashtu, na si komunë iu kemi dalë,

ku ndihmën e parë ata e kanë lyp, sepse aty ka pas ni donator të Blaçit, kanë lyp që 40 mijë euro t'u japim vetëm rrafshimin e stadionit. Edhe e kanë pru ni projekt komuniteti i Blaçit, ai projekt, kur kanë dalë në terren, nuk është përputh me të dhënat dhe është bërë edhe ni herë revidimi i atij projekti, ku prej 40 mijë, 90 mijë euro komuna ka participue për rrafshimin, dhe është t'u krye pjesën e vet të punës, sa i përket stadionit të Blaçit, dhe ai stadion do të kryhet. Pjesa tjetër është e komunitetit të Blaçit, që do ta kryjë fazën e dytë dhe ata duhet edhe ata të fillojnë punimet. Ndërsa faza e tretë është faza e Federatës, e cila e ka parapa që, pasi t'i kryjmë këto punime na, do të participojë vetëm me tepihun e stadiumit. Prandaj nuk janë krye këto faza, komuna e ka krye dhe është t'ua krye fazëne parë dhe të dytën të punimeve të vrazhda, problemi është në kohën edhe te operatori ekonomik. Na jemi lut të gjitha projektet që janë dyvjeçare të fillojnë që në pranverë, mirëpo janë probleme që edhe operatorët ekonomikë kanë zonë edhe punë tjera, edhe nuk po janë në gjendje me na rrijt karshi. Na e kemi problemin edhe me rrugën e Pllajnikut, që disa herë i bëjmë ftesë, nuk vjen. Kemi problem edhe me projekte të tjera dyvjeçare që nuk i kanë fillue ende, prandaj për këtë arsye, ma merr mendja që duhet me pas edhe Blaçi pak durim, po na shpresojmë se do të kryhet edhe ajo. Sa i përket rrugës së Zaplluxhes, qaq është lejue, qaq është punue. Ura në Zaplluxhe është investim i ministrisë dhe e mbikëqyrin përfaqësuesit e ministrisë. Rruga e fshatit Brrut, ti e dish që ajo rruga në fshatin Brrut që shkon për Blaç, në radhë të parë ni herë kemi hi në koncesion edhe na është lejue që të bëhet muri edhe të zgjerohet rruga, dhe ia kemi arrit qëllimit të parë. Masi e kemi arrit qëllimin e parë, sivjet e kemi kontraktue edhe e kemi qit, të gjitha mjetet të cilat kanë qenë nëpër fshatra tjera, për m'u bo arrnimi i rrugëve, i kemi dedikue për qat rrugë të fshatit Brrut, ku kalohet për Blaç. Këtë vit kryhen investimet në atë rrugë. Unë e di që nuk po ju pritet, po brenda një afati qaq të shkurtë kohor këto investime nuk mund të bëhen. Ju mund të kërkoni çka të doni, ju mund të mbani fjalime politike, e keni të drejtën, e keni mikrofonin, por praktikisht këto punët kërkojnë pak kohë.

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Sa i përket stadiumit që thaje, në fshatin Blaç, me rrafshue thaje faza e parë, ju veç të rrafshume s'e keni aty, se ajo nuk është e rrafshume, ajo është e shkatërrume. Te faza e parë, nëse ju keni hi për rrafshim, ka dalë shkatërrim, këtë e ki të garantume, të ftoj me e kqyr, shkojmë bashkë si të duesh, e bojmë ni foto kështu qysh e keni marak. Tjetra, te udha e Zaplluxhes, që thaje ti qaq u planifikue. Nuk u planifikue qaq, po planifikimin e keni të dështum, se ju keni hi me ndreq rrugë e ma shumë shallovonje ju kanë ardhë aty, e dini shumë mirë. Keni hi për rrugë, keni ndreq ma shumë shallovonje se rrugë, ma shumë keni investue në shallovonje, se njerëzit që ju kanë fut aty, mandej ju kanë kushtëzue për me ndreq atë murin mbrojtës. A po kupton? Këtë e keni bo me qëllim, për individë të caktum, që dje edhe keni subvencionue festa atje të paganëve në Zaplluxhe. Të ura që thaje, e dish shumë mirë që është mbikëqyrës edhe komuna aty, se aty ku është mbikëqyrës Ministria e Infrastrukturës e dish çfarë urë është ndërtue, aty te Pllava. Bone krahasimin ti të atyre dy urave, qaty është Ministria e Infrastrukturës edhe e Transportit, te ura e Pllavës, e te ura e Zaplluxhes ka edhe tybestikfa të tjerë. E kam kqyrë shumë mirë, unë e kam kqyrë shumë mirë. Te udha e Brrutit që thaje, aty unë s'po thom që ti e marrish mashinën edhe ia qesish asfaltin, po shkoni bone të kalushme o burrë. Se ajo është edhe e pakalushme. Kurgjo s'e gjë komunën – kryetari u kput t'u i dhonë ka 300 euro këtu për njerëz e për mëditje, e ku e di çka – shko bre futnja ni troh zhavorr qaty, le të bëhet e kalushme, s'është patjetër m'u konë asfalt. Dini bre kqyrne, ni xhiro me kerr veç bonja, me të juajit, jo me të komunës. Merrni kerrat e juaj, hini aty, nëse është e kalushme për kerrat e juaj, është edhe për temin. Pak sanone, veç pak sa të kalojmë, mos e bini situatën kur të vijmë bash gurbetqarët që na me zor i presim, aty me ia nis me punue, me devijue rrugë e me përzie komplet muhabetin, se ju shumë i doni gurbetqarët, e boni ni rreth kah Dragashi, kah Shajnja, ama do rrugë që i kalojnë shumë shpesh qytetarët, qato s'po i kqyrni. Edhe te projektet tjera, unë nuk jam kundër, unë vazhdimisht ju kam përkrahë, e dini shumë mirë, në projekte që janë konë në të mirë të qytetarëve. Vazhdoj me ju përkrah, ama jo në projekte shkatërruese të natyrës. Stadiumin e fshatit Blaç veç e keni shkatërrue. Bile bile, komplet buxhetin fshatit Blaç ia keni çue në stadium edhe keni thonë nuk është i fshatit Blaç stadiumi, po është i Komunës së Dragashit. Nëse është stadiumi i fshatit Blaç, aty po investohen, komplet investimet kapitale që janë parapa për fshatin Blaç kanë shkue në stadium, për çka? Nëse e dish, për vitin që jemi t'u kalue është viti 2023, fshati Blaç i ka pas veç 10 mijë euro të ndame për ni park që e keni nis menihërë sa e keni marrë, bile e keni trashëgue ni projekt të parkit, qe tri vjet jeni t'u bo atë parkin në fshatin Blaç, edhe kurrë s'ia keni fillue. Edhe ni kërkesë që unë ia bona kryetarit, fatmirësisht e pashë sot, ia kam bo vjet në shtator ni kërkesë për rregullimin e atyre mbledhësve të ujit. Je konë këtu besoj kur kam diskutue atëherë. Domethënë, i vetmi investim në fshatin Blaç, është kërkuë m'u bo

ujëmbledhësit, keni thonë hajt se e bojmë, qetash ka ardhë me e miratue buxhetin e vitit tjetër edhe ju s'keni bo kurgjo. Domethënë, në fshatin Blaç, për shkak të stadiumit e keni lonë me 10 mijë euro të atij parkut që ka pas me e bo PDK-ja. Qato jeni t'u e bo qe tri vjet ju. PDK-ja e ka qit atë në listë për me e bo në fshatin Blaç. Kjo është e keqja. Politikë unë nuk bëj, e dish shumë mirë, edhe ju kam mbështet për të mirën qytetare, ama s'është e mirë qytetare m'i shkatërrue ato makinat private qytetarët nëpër ato rrugët. Ajo është e keqe e qytetarëve, unë po foli për qytetarin, s'po foli për Uranin, s'jam t'u bo politikë. Unë po duhet me shkue kah qajo rruga e Brrutit në Blaç. Ti mundish me thonë shko knej, po unë s'qes pare naftë të komunës. Ma ngat e kam ane. Kështu që, nëse s'është koha për me bo me asfalt, hajde procedurat e tenderimit, shkoni rregullone, bone të kalushme atë rrugë. Keni inxhiniera, a s'dalin ata inxhinierë, po i shoh plot do inxhinierë t'o bo foto. Shkoni bre boni foto dikund keq ku është, ni herë, me thonë vallahe p'e bojmë ni foto po qetu keq konga edhe do të intervenojmë. Të martën jam konë në bjeshkë të fshatit Kuk, i kishit çue nja dy bagera aty, a po kuptojsh, ama qysh me shkue deri te asfalti qytetari atje nalt? Nisja prej fillimit, jo prej bishtit, qysh thojnë pleqtë. Më falni që e zgjata! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Munir Jonuzi ni minutë edhe ni minutë Artan Loshaj, edhe po e përmbyllim, po kalojmë te eventuale, se garant qeto kemi m'i përsërit prapë.

**Munir Jonuzi:** Më vjen keq që dola për herë të dytë në foltore, por nuk mora asnjë përgjigje. Nëse përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv nuk e dinë se për çfarë bëhet fjalë, le të thonë që nuk e dimë. Dhe se si do të funksionojë do të shohim në tre muajt e ardhshëm. A do të bisedoni me qytetarët dhe në çfarë mënyre? Drejtori i financave zgjidh disa probleme, e di që kjo komune ka shumë probleme, por e di që duhet të zgjidhen edhe rrugët dhe stadiumet dhe mendoj se përgjigjet për një nevojë thelbësore siç është uji si element thelbësor, kemi e drejta për ta bërë këtë çështje prioritet. E bëj sërish të njëjtën pyetje: Çfarë keni ndërmend të bëni me këtë ujësjellës? Apo ndoshta ju z.Drejtor nuk u përgjigjeni pyetjeve për pjesën e komunës ku jeton komuniteti joshumicë, ndoshta prisni që drejtori i kadastrës të përgjigjet në këto pyetje.

**Artan Loshaj:** Kryesues, pak me ty, me pushtetin. Këta në fillim kanë ardhë si ajo vetëtima, bubullima, po shi nuk bjer. Këta qeshtu e kanë zanat. Edhe e dyta, s'janë konë në pushtet shumë gat edhe këta i kanë bo këto shkel e shko, këto punët, sa me i fitue grantet, kur t'i fitojnë grantet masnej m'i bo rrush e kumbulla. Edhe due me e pyet drejtorin sa ka kushtue rruga Dragash – Stadion, se ky po thotë që e ka bo KFOR-i, po unë, në qoftë se jam gabim i kërkoj falje, unë e di që dikush aty do pare i kanë xigllue kapak, i kanë prek.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë, se po e përmbyllim e po kalojmë te pika eventuale mandej, se hala jemi te KAB-i. A duosh m'i dhonë përgjigje z.Jonuzi, qe dy herë të ka pyet në lidhje me ujësjellësin, edhe për Artanin që tha do pare janë xigllue, s'e di.

**Qamil Kolloni:** Seftja e parë, Uran, si kryesues po të them kështu: për rrugën e Brrutit seriozisht është gjynah me folë. Unë nuk po due inxhinierat m'i mbrojt, po është bo muri dhe nuk lejohet ai muri qaq shpejt m'u shtrure asfalt edhe me ec kerrat me peshë... edhe e kalueshme për m'u bo, rreth murit qëllimisht inxhinierat na kanë thonë nuk bon m'i vu, për arsye se shkojnë kerrat edhe munden me shit, muri është i butë. Tenderi është hap, ka afatet e veta, kryhet, mos e politizo, je kryesues, po të respektojmë, respekto protokolin. Kie të drejtë me folë, po si kryesues nuk duhet me dalë në qat nivel me ra. Mu po më dhimesh. Munir, sa i përket problemit të ujit, problemi i ujit është vital, projekti është i punuar prej një kompanie prestigjioze, me randësi është që ujin do ta biem deri në fshatra edhe në bazen të fshatrave, masnej qysh ndahet, e shohim varësisht cili fshat cilat probleme i ka, se disa fshatra kanë ni bazen dhe mund të shpërndahet prej të njëjtit bazen, veç i shtohet sasia e ujit, kurse disa fshatra kanë nevojë ndoshta edhe bazen të veçantë me iu krijue, disa fshatra kanë problem edhe me rrjetin. Prandaj, kjo është punë e inxhinierave edhe është fazë tjetër. Na do ta çojmë deri në fshat, për kokë banori, secilit fshat, qetyne 15 fshatrave do të ia ndajmë ujin për kokë të banorit edhe për nevojat që i kanë ato fshatra. Pastaj do të bëhet edhe një kontroll tjetër, edhe secili fshat veç e veç, me specifika, do ta përcaktojnë inxhinierat, tash mos të bëhem unë si drejtor i Ekonomisë, Financave, ta luaj rolin e inxhinierit, se qat të drejtë nuk e kam. Besoj që jemi duke bërë përpjekje që të bëhet punë sa ma e mirë. Tash, kaniherë nuk janë edhe do sende në dorën tonë, se na nuk jemi punëkryes, po shpresoj se në këtë projekt i kemi caktue ni menaxherë edhe tre inxhiniera përgjegjës për secilin LOT veç e veç, edhe do të mundohna krejt me e mbajt nën kontroll, qe ky është problemi kryesor i qytetarëve. Sa i përket, Artan, na kemi thonë shumë mirë se KFOR-i dhe na kemi ni memorandum, ni marrëveshje që ia pagujmë naftën KFOR-it, për shpenzime ditore ia kemi pague KFOR-it edhe ajo rruga është hap. Dhe këtu nuk ka diçka ndonjë fshehje. Është memorandum, është publike edhe në uebfaqe, plus edhe ushqimin ia kemi

dërgue, po janë sende që dihen edhe memorandumimi është publik. S'e di pse gjithmonë me shkue me dyshime, s'ka nevojë. Po për qytetarët, po edhe për qytetarët...dëgjo, o kryesues, unë due me qenë korrekt, ju e dini që Komuna e Dragashit ka një uebfaqe...

**Uran Halimi:** Më fal drejtor që po të ndërpres! Çdo pyetje që e bona, janë ato pyetje që m'i kanë adresue qytetarët mu, a po kupton? Qaty është problemi. Te stadioni, unë për Zotin, më fal që po shprehem kështu, sa herë dal unë diku edhe e takoj ni qytetar, thojnë ej po ti i Blaçit bre, çka u bo me stadionin, mendojnë që unë jam menaxher edhe inxhinier i atij projektit. Çka të boj unë, po iu thom, ka kohë atë me e ndreq. Ka kohë po më thojshin shumë me urgjencë u konë. Se tash këtu është problemi, që na ka lind neve nifare konflikti edhe mospërputhje, se u konë shumë me urgjencë, po del shumë me neglizhencë.

**Qamil Kolloni:** Kryesues, jem i bindur që je edhe ma i informuet se unë, po po duesh me e dramatizue në formën tonde. Ti për stadionin e Blaçit je ma i informuet sesa unë, ke mund qytetarëve shumë mirë me ua sqarue, po nuk ke desht, falemiderit mu që po ma bojsh pyetje. Edhe unë po të respektoj, po mundohem për hir të qytetarit me të dhonë përgjigje, po qaj stadion ka m'u bo. A kadal a shpejt, ka me përfundue.

**Uran Halimi:** Atëherë, prapë përgjigjen Munir s'ta ka dhonë. Nejse, tri herë mos pyet hiç, se pyesim masnesër prapë në seancë. Duhet me e ditë projektin edhe planin ai që çohet me dhonë përgjigje. Këta duhet me e pru këtu ni inxhinier që e ka bo projektin edhe për me dhonë përgjigje. Andaj, të nderuar ekzekutiv, meqenëse Muniri ka pyet tri herë, e meriton në seancë me ia pru inxhinierin edhe me ia sqarue ato dyshimet edhe pikëpyetjet që i ka Muniri, se unë qysh e di, shumë fshatra të Gorës kanë probleme me ujësjellësin. Ka me kalue aty pari ujësjellësi, po këta s'po e dinë qetash a kanë m'u lidhë a s'kanë m'u lidhë. Kështu që, bine atë inxhinierin që e ka projektue ujësjellësin, le të ia japë përgjigjet. Po vazhdojmë edhe po e hedhim në votim, e kemi pikën e dytë, miratimi i KAB. Meqenëse dikush tha është kornizë e mirë, ndryshime po besoj që munden me pas. Na realisht qetash, me folë kah del shpirti thojnë pleqtë, kërkesat që i kemi bo vjet në shtator, përpara miratimit të buxhetit, kryetari i ka përfillë edhe i ka respektue, të secilit prej nesh. Unë hiç s'kam dyshime që nëse ka ndonjë lëshim, këta e kanë gatishmërinë për me korrigjue edhe ndryshue, po m'i nejt punës gati. Unë veç qet vërejtje e kam, m'i nejt punës gati. Përndryshe, unë i votoj këto punët që janë të mira, ose që pretendohet për me punue mirë për qytetarët. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Kundër? Abstenim? Dy abstenim, pesë pro edhe zero kundër. Vazhdojmë me pikën e fundit, e kemi pikën eventuale. Qetash kemi të drejtë me bo çështje edhe diskutime të lira. Kush do me e marrë fjalën te pika eventuale? Artani po e kërkon fjalën.

**Artan Loshaj:** Kryesues, për në eventuale, veç i meta borxh drejtorit, stadiumi që po thotë ka pas mbikëqyrës. Po, ka pas, edhe pse ka ik pushteti, mbikëqyrësi i komunës është në komunë. Qaj punëtor që ka qenë me ne, qaj është këtu. Domethënë, mos të thotë çoni ju, po drejtori e di kush është edhe ma ata sot bashkëpunon. Veturat zyrtare keqpërdoren shumë. E dini shumë mirë. Dje e kam ni foto, drejtori në shtatë në sabah i kish harrue syzat te shpia, po shkon me kerr të komunës m'i marrë te shpia. I thashë ku po shkojsh, tha i kam harrue syzat. Drejtori i Shëndetësisë. Për qato e lypa këtu. Ju e dini që për shëndetësinë pa i folë ja dy fjalë nuk bon, se përnime jo që due unë me folë, veç me mush numër këtu, po kemi probleme. Eh po, sa mirë. Nasht, s'ka gajle, se merr vesh edhe shqip, se Boro e Ramiz u bo me drejtorin e Administratës. E kam ni pyetje unë për drejtorin, edhe pse është mas stubit qaty. Ni koeficient që e kanë kërkuë punëtorët e spitalit, ata që janë me Bachelor, shumicës i është refuzue, veç dy vetave i ka kalue. Kam qef me e marrë ni informatë, pse ka ndodhë kjo, a është gabimi këtu apo është në ministri. Edhe pse nuk është mjek, nuk i di këto, po e ka marrë përgjegjësinë edhe pa qare duhet me e pyet. Pse nuk ka barna esenciale për në urgjencë? Ni infusion nuk e kemi për raste urgjente. E di shumë mirë, po s'e di sa na jep përgjigje. Kemi kërkuë që, i treti mandat që jem, ni infermier është në QKMF mas orës 10:00, e kanë pru ni infermier deri në ora 10:00, po mas orës 10:00 ni infermier shkon për në Prizren, ni infermier merret me krejt rastet e Komunës së Dragashit. Në seancën e fundit ia kam bo ni pyetje kryetarit, a ka të drejtë Qendra e Mjekësisë Familjare, sektori i urgjencës me dalë në aksidente, a jo, pa mjekë. Për arsye se, hiç ma larg se para dy dite e kemi pas ni aksident me fatalitet dhe punëtori i spitalit shkon me kerr në Prizren, e lajmëron policia, thotë hajde, doktori s'ka qysh me dalë, se nuk dilet pa mjekë në aksidente me fatalitet, jemi detyrue me shkue me thirrë mjekun te shpia, me marrë doktorin, me pru policia, kerrin e spitalit me pru prej Prizrenit, me shkue me konstatue vdekjen. Kjo është ni turp i madh që nuk ndodh kërkund në Republikën e Kosovës, veç në Komunën e Dragashit. Mos ta merr pushteti këtë si kritikë, se kjo kritikë ka qenë edhe me pushtetin e PDK-së, të partisë ku unë vij. Tash edhe vjen sezona, ka edhe shumë raste, ka edhe shumë fluks, ka edhe shumë bashkëqytetarë tanë që vijnë nga

mërgata e që i don shumë ky pushteti. Është mirë së paku m'u marrë bre, ja dy infermierë, katër infermierë i duhen urgjencës, 5 mijë euro vjetore është me pague, bile ma pak, se prej 18 euro në 7 euro e kanë ulë kujdestarinë. Me 2-3 mijë euro i paguani katër infermierë, me punue natën edhe mos me ia bart hiç gjale ju, se është marre, është turp. Vjen drejtori qaty, sillet, ma shumë sillet me tenderat e komunës m'i ndërtue ato dyer e penxhere, se që merret me punëtorët, e që merret me barnat esenciale, e që merret me problemet e shëndetësisë. Ni drejtori që e kemi tash, atë veç e kanë lonë për emër, se asnjë kompetencë nuk ia kanë lonë edhe po i bëj thirrje edhe ni herë, si shok edhe si... a ka mundësi me na dhonë ni përgjigje, a do të merret me këto probleme ajo, në mënyrë shumë serioze, se të gjithë punëtorët janë shumë të neglizhuet, janë shumë të demoralizuet. Në krejt Kosovën, qe Arijetën e kemi kolege këtu infermiere, në krejt Kosovën bachelorat e kanë të kryme koeficientin, krejt Kosova e kanë të kryet rrezikshmërinë, veç Komuna e Dragashit, është për të ardhë keq, prej 20-30 punëtorë që kanë bo kërkesë, veç dy kanë kalue. Ata dy qysh kanë kalue, mirë që kanë kalue, po s'e di. Pse këta tjerët nuk kalojnë, kemi për shembull maminë me master edhe paguhet si me shkollë të mesme. I lutem edhe ni herë drejtorit ni përgjigje me na dhonë!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Loshaj! Te kjo pyetje e barnave esenciale, unë e pashë ma herët që janë nda shumë fonde sivjet, apo? Edhe realisht, edhe vetë kam vizitue qendra të mjekësisë familjare, s'ka baby-system për fëmijët, infuzion patjetër që kam ble edhe gjithçka tjetër. Ka pas diçka që s'm'u desht, tha veç qesi ka, po ajo s'u dukke. Domethënë, për raste urgjente, nëse ke mund me pa, drejtori u konë te ai motomitingu që u zhvillue të dielën e kalume, edhe ty s'kam unë infermierë, veç shofer të urgjencës. Infermier a pat, drejtor? S'ka pas jo, se kam pyet. Kështu që, edhe te motomitingu u konë veç ai shoferi i urgjencës, nuk ka pas infermier në terren. Paramendo me pas ndodhë diçka, janë konë 200-300 të ftum aty, edhe motorist që është sport paksa ekstrem, çka munden me i bo ai shoferi. Për me të transportue, unë edhe me motor ta bie deri në ambulancë. Po duhet me pas infermier, po besoj. Drejtor, po të ftoj me e marrë fjalën!

**Behar Brenoli:** Përshëndetje të gjithëve, do ta filloj nga fundi, meqë përmendët takimin moto meeting, për sa i përket sigurisë, është mirë që të gjitha aktivitetet e tilla që zhvillohen në komunën tonë të shoqërohen ashtu siç i ka hije me ekipeve të Emergjencave. Mirëpo ne si drejtori jo vetëm që skishim një kërkesë, por edhe asnjë njoftim se do të zhvilloheshin aktivitetet e tilla nga organizatorët. Sigurisht, nëse do të ishim të informuar, do të mundoheshim të menaxhonim disi me kapacitetet tona, të cilat nuk janë të mëdha. Për sa i përket koeficienteve, edhe unë jam i zhgënjyer si ju, por disa nga punëtorët tanë kanë bërë kërkesa apo ankesa dhe kjo nuk varet nga drejtorja. Ankesat përmes komunës janë bartur në ministrinë kompetente dhe ato i kanë shqyrtuar ankesat. Me sa di unë, Drejtorja e Shëndetësisë nuk kishte absolutisht asnjë informacion apo lidhje me ato kërkesa sepse nuk është juridiksioni ynë. Pajtohem që koeficientët nuk janë të mirë dhe kur Ligji për paga thotë qartë se diploma bachelor në kujdesin parësor shëndetësor duhet të ketë 5.4 dhe këtu është 5.1, nuk është e drejtë. Ne si drejtori do t'i kërkojmë ministrisë përkatëse ta zgjidhë këtë. Për sa i përket punës së teknikut pas orës 10:00, ju e dini situatën, ne do të përpiqemi siç kemi premtuar së bashku me kryetarin të përpiqemi të sigurojmë të paktën një teknik më shumë gjatë verës. Për barnat nuk kam çfarë të them, sepse edhe ju e dini që ne furnizohemi nga ministria. Sa dërgojnë, kaq, sepse ne nuk mund të ndikojmë në këtë, ne përpiqemi të ofrojmë shërbime emergjente nga fondi ynë, megjithatë ministria jep aq sa ata mendojnë se është e nevojshme, bazuar në numrin e banorëve dhe numrin e pacientët. Përsa i përket nevojës është më e madhe, por ju e dini më mirë se unë në kujdesin parësor se cilat trajtime mund të kryhen. Nëse ju japin, për shembull, 50 infuzione në një muaj, çfarë do të bëni me të? Do të thotë se nuk i plotëson as nevojat elementare. Ju e dini këtë më mirë se unë. Ilaçet esenciale i marrim nga Ministria e Shëndetësisë.

**Uran Halimi:** Drejtor, veç ni second, deshta me të pyet, se aty u konë ni autoambulancë, që thaje s'kemi pas ftesë, kah shkoi qajo, ta ka pi duhanin dikush kahtinëz. Kush e thirri atë? Okej, ma japish përgjigjen masnesër në seancë të rregullt. Edhe ni pyetje tjetër kam desht me bo në përgjithësi, edhe për drejtorin: Kolegia jeme, Xhyllferija, ka kërkuar ni dhomë për ndërrimin e fëmijëve aty, a është krye qajo, nëse mundni me më kallxue? Po a? Okej, faleminderit për kontributin! Okej, Artani e ka, ni minutë Artan, të lutem!

**Artan Loshaj:** Po, u bo, e falënderoj zonjën e nderume, se kjo nuk e ka bo për vete, e ka bo për krejt qytetarët e Komunës së Dragashit, e këta që shohin shkurt edhe mendojnë shkurt, këta mendojnë që si opozitë kërkoj për Artanin ose fëmijën tem. Jo, unë kërkoj për krejt qytetarët e Komunës së Dragashit, se...s'është për m'u kesh, është për me vajtue zotni drejtor, po ju këto sendet i merrni pak si me siklet, edhe është mirë. drejtor, harrova ma

herët se nuk është problemi veç te infemierët, po është problemi edhe te dy mjekët që janë në specializim. Ata duhet ta kenë koeficientin 8, ndërsa ata janë prapë me ni koeficient 7.4 si mjek të përgjithshëm, edhe mos të shkoj me emra, se s'është problem se i kam pyet, është doktor Nazmi Velia dhe është Nexhmedin Ahmeti, të cilët kanë vendim që janë në specializim, ndërsa pagesa iu bëhet si mjek i përgjithshëm. Deshta m'u lidhë edhe unë me kryesuesin, ku thaje që në miting nuk keni pas ftesë. Shumë e sigurt është se ftesë ka pas QKMF. Pse ato politikat e juaja me drejtorin që s'mundni me menaxhë njëri-tjetrin, njëni pozitë e qetri opozitë, aty po pësojnë të gjithë qytetarët e komunës. Ftesa ka qenë, mirë tha edhe kryesuesi, se pse veç shoferi ka qenë aty prezent, dikush, tha mirë, ta ka pi cigaren kahtinëz, po është problem tjetër ai i yti. Te infemierët, që po thu veç në sezonin e verës, nuk është e mundshme se pacientët nuk smuhen veç verës. Smuhen edhe dimrit, smuhen edhe jashtë sezonës. Edhe e dijshe shumë mirë, ose në qoftë se nuk e dijshe, të jap informata, se di edhe s'dijshe edhe s'pyesish, unë jam ai që të jap informata se punoj aty, ni vendim i drejtorisë është, jo i pushtetit, i drejtorisë, se me ardhë kush me ardhë në pushtet pacienti është pacient, është ni vendim që kerri, autoambulanca e cila shkon për Prizren me transportue pacientin shkon me përcjellës. Edhe tash, sonte jam kujdestar unë, në ora dy të natës munden m'u smu dikush i familjes tonde, ishalla jo, edhe duhet infemieri me shkue të smutin me përcjellë, ndërsa QKMF, krejt urgjenca, krejt Komuna e Dragashit jet me ni mami edhe me ni mjek, për fat të keq. Ma herët keni thonë se nuk kemi pare, tash prej 18 euro e keni bo 7 euro, për 1500 euro vjetore m'i pague katër infemierë, kjo është turp. 1500 euro ti i hargjojshe benzin që shkojshe tutje-teknena, mujore jo vjetore., thashë edhe ni herë, për 1500 euro hargjoni benzin ju për ni muaj ditë. Ni vjet m'i pague punëtorët edhe flini rahat edhe ju edhe pushteti te shpia, edhe i merrni votat për zgjedhjet tjera!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nëse jo, e mbyllim këtë Komitet...përgjigjen për masnesër, ia kam lyp edhe unë do përgjigje. Po. Shihemi masnesër, e gëzofshi festën e Kurban Bajramit, e ishalla shihemi për të mirë!

*Kryesuesi i KPF-së  
Uran Halimi*